

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7127  
E martë, 27 shkurt 2024  
Çmimi 0.50 €

## Borrelli: Takimet me Kurtin dhe Vuçiqin në Munih, të pasuksesshme



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

MANIFESTIM MADHËSHTOR ME BASHKATDHETARË NË AARGAU TË ZVICRËS | F. 4-5

## KRYETARI I DEGËS SË PDK-së NË ZVICËR THOTË SE MIJËRA BASHKATDHETARË I JANË BASHKUAR VIZIONIT TË PDK-së



Dega e Partisë Demokratike të Kosovës në Zvicër ka organizuar shënimin e 16-vjetorit të Pavarësisë në kantonin Aargau. Kryetari i kësaj dege, Ragip Xhaka, ka theksuar se prej që është organizuar shtrirja e PDK-së

nëpër kantonet zvicerane, me mijëra bashkatdhetarë i janë bashkuar vizionit të PDK-së. Ai i ka ftuar bashkatdhetarët të bëhen pjesë e rrugëtimit të PDK-së për ta sjellë ndryshimin e kërkuar në Kosovë. E

kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili së bashku me bashkëpartiake ishte i pranishëm në këtë organizim, ka thënë se mërgimtarët janë katalizatori i secilit zhvillim të rëndësishëm në historinë e vendit tonë

### AKTUALE



MË 15 DHE 16 PRILL NË PRISHTINË MBAHET FORUMI NDËRKOMBËTAR PËR GRATË, PAQEN DHE SIGURINË F. 3

KONJUFCA SHPALLET I PAFAJSHËM PËR HEDHJE TË GAZIT LOTSJELLËS NË KUVEND F. 5

KRYEMINISTRI PALESTINEZ JEP DORËHEQJE F. 2


### EKONOMI



KURTI NËNSHKRUAN MARRËVESHJE PREJ 400 MILIONË EUROSH ME BERZH-in F. 8

KEDS-I ZGJIDH PROBLEMIN PËR SHUMË DEKADA NË NJË NGA FSHATRAT ME SIPËRFAQEN MË TË MADHE NË KOSOVË F. 8

### SPORT



FERATI: SYNOJMË KUALIFIKIMIN NË BOTËROR F. 10

KURTI: PARTNERJA JONË TREGTARE ËSHTË BE-JA, S'DUAM TË BASHKËPUNOJMË ME RUSINË F. 3



DERI NË NJË VIT E GJYSMË PRITJE PËR KRYERJEN E KORONAROGRAFISË NË QKUK F. 4



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Kryeministri palestinez jep dorëheqje

**RAMALLAH, 26 SHKURT** - Kryeministri palestinez Mohammed Shtayyeh tha të hënën se po jep dorëheqje për ta lejuar krijimin e një konsensusi të gjerë ndërmjet palestinezëve mbi marrëveshjet politike pas luftës në Rripin e Gazës.

Kjo sinjalizon një gatishmëri nga udhëheqja palestineze e mbështetur nga Perëndimi për të pranuar ndryshime që mund të çojnë në reforma, të cilat shihen si të nevojshme për ta rigjallëruar Autoritetin Palestinez.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës duan një Autoritet Palestinez të reformuar që do ta qeverisë Rripin e Gazës pasi të përfundojë

lufta në mes të Izraelit dhe Hamasit, të cilin ShBA-ja dhe Bashkimi Evropian e konsiderojnë organizatë terroriste.

Presidenti Mahmud Abbas duhet të vendosë nëse do ta pranojë dorëheqjen e kryeministrit Shtayyeh dhe qeverisë së tij dhe mund t'i kërkojë atij të qëndrojë në detyrë derisa të emërohet një zëvendësues i përhershëm.

Në një deklaratë për qeverinë, Shtayyeh, një ekonomist akademik që mori detyrën në vitin 2019, tha se faza tjetër duhet ta marrë parasysh realitetin e ri në Rripin e Gazës, i cili është shkatërruar pas gati pesë muajsh

luftime të rënda.

Ai tha se, përveç aranzhimeve të reja politike, "duhet shtrirja e autoritetit të administratës (palestineze) në të gjithë vendin, Palestinë".

Autoriteti Palestinez, i formuar 30 vjet më parë sipas Marrëveshjes së Përkohshme të Paqes të Oslos, ka autoritet të kufizuar mbi pjesë të Bregut Perëndimor të pushtuar, por humbi pushtetin në Gaza pas luftimeve me Hamasin në vitin 2007.

Fatah, i cili kontrollon Autoritetin Palestinez, dhe Hamasi, kanë shtuar përpjekjet për të arritur një marrëveshje për një qeveri uniteti dhe do të



takohen në Moskë të mërkurën. Një zyrtar i lartë i Hamasit tha se masa duhet të shoqërohet me një marrëveshje më të gjerë për autoritetin mbi territoret palestineze. "Dorëheqja e qeverisë Shtayyeh ka kuptim vetëm nëse është në kontekstin e

një konsensusi kombëtar për marrëveshjet për fazën tjetër", tha për Reutersin zyrtari i lartë i Hamasit, Sami Abu Zuhri.

Izraeli është zotuar ta shkatërrojë Hamasin dhe thotë se për arsye sigurie nuk do ta pranojë sundimin e Autoritetit Palestinez mbi Gazë pas luftës, që shpërtheu pas një sulmi të Hamasit në Izraelin jugor më 7 tetor, në të cilin, sipas të dhënave izraelite, u vranë rreth 1 200 njerëz.

Nga përgjigjja e Izraelit me sulme ajrore e tokësore në Rripin e Gazës deri tani janë vrarë rreth 30 000 palestinezë, sipas autoriteteve shëndetësore të kontrolluara nga Hamasi.

# Ndihmësja thotë se Navalny u vra derisa po negociohej për këmbimin e tij

**MOSKË, 26 SHKURT** - Maria Pevchikh, ndihmësja e politikanit opozitar rus Aleksei Navalny, ka pretenduar se një këmbim i të burgosurve - ku ka qenë i përfshirë edhe kritiku i Kremlinit - ka qenë në fazën përfundimtare para se ai të vdiste në një burg në Siberi.

Pevchikh, udhëheqëse e Fonadacionit të Navalnyt Kundër-Korrupsionit, ka thënë të hënën përmes një videoje në YouTube se ndihmësit e Navalnyt kanë punuar për dy vjet që t'i bindin zyrtarët e Perëndimit për të negociuar një marrëveshje që do ta përfshinte kritikun e Kremlinit dhe dy shtetas amerikanë të mbajtur në burgjet ruse, për Vadim Krasikovin, ish-kolonelin e Shërbimit Federal të Sigurisë (FSB) në Rusi, i cili është dënua për vrasje të një ish-luftëtari çeçen në Berlin më 2019.

Ajo nuk i ka përmendur emrat e dy shtetasve amerikanë që ishte planifikuar të këmbeshin. Aktualisht janë disa amerikanë që po mbahen në burgjet ruse, përfshirë ish-marinsin Paul



Whelan, gazetarin e së përditshmes amerikane "Wall Street Journal", Evan Gershkovich, dhe gazetaren e "Radios Evropa e Lirë", Alsu Kurmasheva.

Navalny do të përfshihej në marrëveshje si pjesë e një "këmbimi humanitar". "Në fillim të shkurtit, Putini i është ofruar ta këmbejë vrasësin e FSB-së, Vadim Krasikov, i cili është duke vuajtur dënimin për një vrasje në Berlin, për dy shtetas amerikanë dhe Aleksei Navalnyn. E kam pranuar

konfirmimin se negociatat ishin në fazën finale në takimin e 15 shkurtit. Më 16 shkurt, Aleksei është vrarë", ka thënë Pevchikh. "Aleksei Navalny do të mund të ishte ulur me ne këtu sot", ka shtuar ajo.

Deklaratat e saj nuk janë konfirmuar dhe as kundërshtuar prej burimeve të tjera.

I pyetur për këtë çështje më 26 shkurt, zëdhënësi i Qeverisë gjermane, Christiane Hoffmann, ka thënë se nuk mund të komentojë.

Më herët gjatë këtij muaji Putini

i ka thënë komentatorit amerikan Tucker Carlson, se "një marrëveshje mund të arrihet", për ta liruar Gershkovichin, i cili është arrestuar në mars të vitit të kaluar në Rusi, nën akuzat për spiunim, të cilat ai dhe qeveria i kanë konsideruar të pabazuara, me një "patriot" rus, që po vuan dënimin në Gjermani, dhe kjo besohet se ka qenë referencë për Krasikovin.

"Wall Street Journal" i ka cituar zyrtarët perëndimorë në atë kohë, të kenë thënë se Putini dëshiron që Krasikov të këmbehet për dy të burgosur amerikanë, përfshirë Gershkovichin.

Në video, Pevchikh ka dyshuar që Putini "nuk e ka toleruar" lirin e Navalnyt dhe në vend të këmbimit, "ka dashur ta heqë qafe krejtësisht".

Ajo nuk ka dhënë dëshmi për ta mbështetur pretendimin e saj.

Sipas saj, miliarderi rus Roman Abramovich ka qenë "negociator jozyrtar" në mes të Kremlinit dhe zyrtarëve evropianë. "E kam pyetur Roman Abramovichin për kushtet dhe çfarë ka thënë

Putini. Fatkeqësisht, Abramovich nuk u është përgjigjur pyetjeve, por as nuk ka mohuar asgjë", ka thënë Pevchikh.

As Abramovich dhe as Kremlini nuk e kanë komentuar këtë deklaratë të saj.

Trupi i Navalnyt i është dorëzuar familjes përgjatë fundjavës, një javë pasi është bërë publike vdekja e tij në burgun e ashtuquajtur "Ujku Polar" në Arktik.

Ai ka qenë duke vuajtur dënimin me burgim prej 19 vjetëve, nën akuzë që ai dhe mbështetësit e tij i konsiderojnë të motivuara politikisht.

Ende nuk dihet shkaku i vdekjes së tij.

Nëna e Navalnyt i ka akuzuar zyrtarët rusë se i kanë bërë presion që të organizojë një ceremoni sekrete të varrimit për djalin e saj për të shmangur turmat e njerëzve.

Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, ka thënë më 26 shkurt se është "absurde" të pretendohet se familjes së Navalnyt i është bërë presion.

## HRW akuzon Izraelin për bllokimin e ndihmës për palestinezët në Gazë

**GAZA, 26 SHKURT** - Izraeli ka dështuar ta respektojë urdhrin e gjykatës më të lartë të Kombeve të Bashkuara për të ofruar ndihmë urgjente për popullsinë në Rripin e Gazës, tha organizata Human Rights Watch më 26 shkurt, një muaj pas vendimit të publikuar nga gjykata në Hagë, që urdhëroi ta parandalojë vdekjen dhe shkatërrimin në enklavën palestineze.

Në përgjigjen e parë ndaj rastit të ngritur nga Afrika e Jugut që e akuzoi Izraelin për gjenocid,

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) urdhëroi Izraelin që të bëjë gjithçka që ta shmangë vdekjen, shkatërrimin dhe çdo veprim të gjenocidit në Gazë. Por, GjND-ja nuk urdhëroi dhënin fund të ofensivës ushtarake që ka nxitur një katastrofë humanitare në enklavën e vogël palestineze. Izraeli mohon akuzat ndaj tij, duke thënë se po lufton në vetëmbrojtje.

Një muaj më vonë dhe pothuajse pesë muaj luftë, përgatitjet po bëhen që Izraeli

ta zgjerojë operacionin e tij tokësor në Rafah, qytezën më jugore të Gazës që gjendet përgjatë kufirit me Egjiptin, ku 1.4 milion palestinezë janë strehuar për shkak të luftimeve në pjesë të tjera të enklavës palestineze.

Organizata Human Rights Watch tha se Izraeli nuk po respekton vendimin, në pjesën kur flet për ndihmën humanitare. Kjo organizatë tha se prej që është marrë vendimi ka pasur rënie prej 30-përqindësh të numrit të



kamionëve me ndihmë që hyjnë çdo ditë në Gazë. Po ashtu, organizata akuzoi Izraelin se nuk po lehtëson

dërgesat me karburante për në veri të Gazës dhe fajësoi Izraelin se po bllokoi që në këtë pjesë të arrijë ndihma.

# Kurti: Partnerja jonë tregtare është BE-ja, s'duam të bashkëpunojmë me Rusinë



**LONDËR, 26 SHKURT** - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se partnerët kyçë tregtarë të Kosovës janë shtetet e Bashkimit Evropian.

Në samitin për investime në Ballkanin Perëndimor, të mbajtur në Londër, Kurti u pyet për partneritetin tregtar me shtetet që nuk e njohin Kosovën. Ai tha se një nga to është Rusia, me të cilën, Kosova, sipas tij, nuk do partneritet. "Partnerja jonë kyçe tregtare është BE-ja dhe ne duam që ta forcojmë dhe thellojmë këtë bashkëpunim", tha Kurti në samitin e organizuar nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. "Ne nuk kemi raporte me Federatën Ruse. Ne i kemi vendosur sanksione Federatës Ruse. Ne duam që Ukraina të fitojë dhe na duhet e gjithë Evropa demokratike dhe bota të shohim Kremlinin dhe presidentin despotik [Vladimir] Putin të mposhtur. Nuk jemi duke bashkëpunuar me ta, edhe nëse ata do të donin, ne nuk duam. Kemi disa importe nga Kina, por shtetet e BE-së janë partneret tona kyçe tregtare", shtoi ai.

Gjatë panelit të diskutimit, ku morën pjesë gjashtë kryeministrit e shteteve të rajonit të Ballkanit Perëndimor, u tha se përmirësimi i infrastrukturës rrugore, hekurudhore e detare, tranzicioni në energji të gjelbër, por edhe zbatimi i reformave për përmirësimin e mjedisit biznesor, janë tri prioritetet kyçe të këtyre shteteve sa i përket tërheqjes së investimeve të huaja.

Në Londër udhëheqësit e gjashtë shteteve ballkanike thanë se pozita gjeografike e tyre, që shërben si lidhje me pjesë të ndryshme të Evropës, bën që rajoni të jetë tërheqës për investitorë të huaj. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha se në shtetin e tij ka fuqi të re punëtore dhe kosto konkurruese tregtare. "Qeveria jonë është e fokusuar në sundim të ligjit, në luftimin e korrupsionit dhe në linjë të plotë me ShBA-në, BE-në dhe Mbretërinë e Bashkuar në aspektin gjeopolitik dhe në vlera edhe në aspektin e të bërit biznes".

Pas panelit, kryeministri Kurti njoftoi për nënshkrimin e një

memorandumi të mirëkuptimit me BERZh-in në vlerë prej 400 milionë eurosh investime "në sektorët tanë prioritarë" për periudhën 2024-2027.

Gjatë panelit, kryeministrja serbe, Ana Bërnabiq, tha se shteti i saj është i fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore, në shndërrimin në një ekonomi të inovacionit teknologjik. Nga BERZh-i, Shqipëria dhe Serbia u vlerësuan për punën e tyre sa i përket tranzicionit në energji të gjelbër. Shqipëria tha se tashmë varet krejtësisht nga energjia diellore dhe ajo me erë, ndërkaq edhe shtetet e tjera të rajonit, përshirë Kosovën, njoftuan për planet e tyre për t'i përdorur resurset e ripërtërishe për energji.

Kryeministri Kurti përmendi përmbylljen e ankandit për një park të energjisë diellore në Kosovë, me kapacitet prodhimi prej 100-megavatesh në orë. Ai paralajmëroi për një projekt të ngjashëm, por me energji të erës, më vonë gjatë këtij viti. "Na duhen më shumë investime [të huaja direkte]. Por, Kosova është vend

ku mund të bëhen investime, sepse ato veçse po ndodhin", tha Kurti.

Lidhjet më të mira mes shteteve të rajonit, gjatë samitit, u tha se ndihmojnë Ballkanin Perëndimor të lëvizë drejt tregut të përbashkët të Bashkimit Evropian. Në këtë drejtim, të gjashtë shtetet ballkanike përmendën projektet e tyre rrugore, hekurudhore që lidhin më mirë me njëra-tjetrën dhe me pjesën tjetër të Evropës. Gjatë samitit kryeministrja serbe Bërnabiq teksa iu referoi shifrave për investime dhe rritje ekonomike, tha se ato iu referohen Serbisë Qendrore, pa përfshirë "Kosovën dhe Metohinë", që tha se është pjesë e Serbisë.

Kësaj deklarate iu përgjig Kurti: "Emri i shtetit tim është Republika e Kosovës. Nuk është ashtu siç iu referua këtu si 'Kosovë e Metohi'. Po të ndiqja këtë shembull, do t'ju merrja shumë kohë sepse në vend të Serbi, do të thosha: Serbia dhe Vojvodina dhe Sanxhaku, Toplica, Rashka, Lugina e Preshevës dhe rajoni i Timokut", tha Kurti, teksa Bërnabiq u dëgjua

duke thënë se një deklaratë e tillë nuk përkon me realitetin.

Kosova ka shpallur pavarësinë më 2008 dhe njihet nga 117 shtete, por Serbia vazhdon ta konsiderojë pjesë të saj.

Tensionet mes dy shteteve janë rritur së fundmi për shkak të një vendimi të Kosovës për ta ndaluar përdorimin e dinarit serb për pagesa me para të gatshme. Bashkimi Evropian, që ndërmjetëson dialogun për normalizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, ka kërkuar që çështja të zgjidhet në këtë proces.

Shtetet e Bashkuara, që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në proces, por e mbështesin atë, kanë kërkuar që Kosova ta shtyjë zbatimin e vendimit, duke thënë se vendimi nuk ka marrë parasysh efektet negative që ka te komuniteti serb.

ShBA-ja dhe BE-ja, po ashtu, u kërkojnë palëve që përmes dialogut të arrijnë deri te një zgjidhje, me ShBA-në që ka thënë se një marrëveshje nga dialogu, eventualisht do të çonte drejt njohjes së ndërsjellë.

## Më 15 dhe 16 prill në Prishtinë mbahet Forumi Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë

Prishtinë, 26 shkurt - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka njoftuar se më 15 dhe 16 prill 2024 në Prishtinë do të mbahet Forumi Ndërkombëtar për Gratë, Paqen dhe Sigurinë. "Prishtina do t'i hapë dyert sërish për pjesëmarrës nga mbarë bota me qëllim të bashkëpunimit për siguri e paqe të qëndrueshme dhe

gjithëpërfshirëse", ka thënë ajo përmes një videoje të publikuar në faqen e saj në "Facebook". Ajo ka treguar se në edicionin e parë të Forumit mirëpritën liderë, akademikë, ekspertë, kampione të agjendës për gratë, paqen dhe sigurinë nga e mbarë bota për të trajtuar çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë dhe mirëqenien e grave

në mbarë botën. "Nga qëndrimi kundër dhunës seksuale gjatë luftës deri tek çështjet e sigurisë klimatike gratë janë heroina të cilat bashkojnë përherë inteligjencën dhe integritetin në shërbim të paqes dhe sigurisë", ka theksuar Osmani.

Në këtë forum do të jenë të pranishëm 500 pjesëmarrës nga 33 shtete.





# Deri në një vit e gjysmë pritje për kryerjen e koronarografisë në QKUK

**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Ka gati një vit e gjysmë që Zejush Misini, rreth 60 vjeç, pret për të bërë një koronarografi në Klinikën e Kardiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Kjo procedurë shërben për t'i diagnostikuar problemet në zemër, përkatësisht për t'i analizuar enët që e çojnë gjakun në zemër. Varësisht rezultatit të saj, pacienti mund të referohet për procedura të tjera deri tek operacioni.

Misini - i cili vjen nga komuna e Obiliqit, rreth 10 kilometra larg Prishtinës - tregon se mjeku i tij ia ka rekomanduar koronarografinë qysh në shtator të vitit 2022. "Nuk e di pse duhet pritur kaq gjatë. Mendoj se nuk është normale të pritet kaq gjatë", thotë ai. "Radio Evropa e Lirë" bisedoi me të në javën e tretë të shkurtit, kur ai kishte shkuar në QKUK - për të disatën herë - për t'u interesuar për termin.

As atë ditë nuk kishte marrë përgjigje pozitive, me justifikimin se prioriteti i kanë rastet urgjente.

Misini dyshon se mund të ketë nevojë për vendosje të stentës në zemër - një spirale që ndihmon për t'i mbajtur hapur enët e gjakut - sepse, siç thotë, "disa analiza që i kam

bërë, nuk po më dalin mirë".

## Çfarë thonë mjekët?

Drejtori i Kardiologjisë, Lulzim Kamberi, pranon se ka lista të gjata pritjesh në klinikën që udhëheq. Kjo, sipas tij, ndodh për faktin se pacientët nga e gjithë Kosova referohen në QKUK. Po ashtu, ka edhe një numër të madh pacientësh që referohen nga klinikat e tjera të QKUK-së. "Gjithçka që kemi mundësi dhe kushte, jemi duke e bërë. Rastet urgjente nuk presin. Ato trajtohen menjëherë. Jemi shumë të ngarkuar me punë", thotë Kamberi për "Radion Evropa e Lirë".

Pos në QKUK, koronarografitë kryhen edhe në disa spitale private në Kosovë, por janë shumë më të kushtueshme.

Kamberi thotë se brenda ditës në Kardiologji kryhen 10 deri në 13 procedura të tilla. Klinika i ka vetëm dy salla që, sipas Kamberit, nuk mjaftojnë. "Jemi me një sallë, ndërsa një tjetër është rinovuar para tre muajsh. Na duhen minimumi edhe dy-tri salla të tjera", thotë ai.

Kamberi kujton se deri vonë ka qenë një komision që e ka përpiluar listën e pacientëve që kanë nevojë për koronarografi, ndërsa tash

rastet regjistrohen vetë, vetëm me një rekomandim të mjekut. "Më herët janë regjistruar 5-6 pacientë në ditë, kurse tani kemi 15 e më shumë", thotë ai. Një arsye tjetër që mund të ketë ndikuar në fluks të madh pacientësh është edhe vetëdijesimi gjithnjë e më i madh i qytetarëve për shëndetin, thotë kardiologu Agron Qerimi, i cili punon në një institucion privat në Kosovë.

Pritjet për një periudhë të shkurtër ndodhin edhe në vende të tjera, por jo më shumë se një vit. "Duhet të mundohemi që pacientëve t'u ofrojmë shërbime sa më të hershme, sa më të shpejta, sa më kualitative dhe më të sigurta", thotë Qerimi.

## Sa persona janë në pritje?

Duke folur në kushte anonimiteti, një infermiere e Kardiologjisë i tha "REL"-it se aktualisht janë mbi 1 600 persona në listë të pritjes për koronarografi. Pritja, sipas saj, zgjat nga disa javë deri në disa muaj. "Ka raste kur i thërrasim pacientët dhe na thonë: jo, e kemi kryer këtë punë... Ka raste kur na konfirmojnë se vijnë dhe nuk paraqiten... Por, ka raste edhe kur na thonë se

pacienti ka vdekur", tha ajo.

Këto të fundit, sipas saj, janë kryesisht "të moshave mbi 80 vjeç".

Në një nga takimet e fundit, Bordi i Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) - institucion që mbikëqyr QKUK-në dhe spitalet rajonale - u bëri thirrje udhëheqësve të klinikave t'i kushtojnë më shumë kujdes planifikimit të terminëve për pacientë.

Duke diskutuar konkretisht për situatën në Kardiologji, bordi tha se pritjet deri në një vit e gjysmë janë "të pakuptimta dhe të paarsyeshme". I pyetur nga REL-i nëse ka plane konkrete për trajtimin e kësaj problematike, drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, Elvir Azizi, tha: "Ne planifikojmë të ndajmë edhe mjete të tjera për Klinikën e Kardiologjisë në mënyrë që të ofrojmë sa më shumë shërbime dhe ta ulim numrin e rasteve në pritje".

Azizi nuk specifikoi më shumë, por për vitin e kaluar ShSKUK-ja ndau 1.62 milion euro për furnizimin e Kardiologjisë me material shpenzues dhe stenta. Atë vit, sipas një dokumenti që pa Radio Evropa e Lirë, në Kardiologji janë kryer 4 050 koronarografi dhe janë vendosur 3 458 stenta. Sipas drejtorit të ShSKUK-së, shumë

e ngjashme parash është ndarë edhe për vitin 2024. Por, Kardiologjia nuk është e vetmja klinikë, ku pacientët përballen me pritje. "REL"-i ka raportuar më herët për pritje deri në tre vjet në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare të QKUK-së dhe në të tjera.

Atëkohë nga Ministria e Shëndetësisë kanë thënë se "përmirësimi i cilësisë së shërbimeve është i paraparrë të bëhet përmes decentralizimit të sistemit spitalor dhe riorganizimit të QKUK-së". Por, ndërkohë që pritjet e gjata vazhdojnë, një faktor që nuk i ndihmon ato, është edhe mungesa e mjekëve.

Kosova prej vitesh përballlet me largimin e stafit shëndetësor.

Të dhënat e Odës së Mjekëve të Kosovës tregojnë se vitin e kaluar 160 mjekë kanë marrë të ashtuquajturën certifikatë të pastërtisë etiko-profesionale, që do të thotë se janë larguar nga Kosova, ose janë në proces të largimit. Sipas kësaj ode, të larguarit - që kryesisht emigrojnë drejt vendeve të Bashkimit Evropian - ankohen për kushte jo të mira pune, paga të ulëta dhe keqmenaxhim.

Paga bruto e një mjeku specialist në Kosovë është rreth 1 200 euro, ndërsa në Gjermani, për shembull, arrin mbi 4 000 euro.

# Borrelli: Takimet me Kurtin dhe Vuçiqin në Munih, të pasuksesshme

PRISHTINË, 26 SHKURT - Shefi i diplomacisë i Bashkimit Evropian, Josep Borrell, tha se ka pasur takime "të pasuksesshme" me udhëheqësit e Kosovës dhe të Serbisë sa i përket shtensionimit të situatës mes dy shteteve.

Në një artikull të publikuar pas mbajtjes së Konferencës së Sigurisë në Munih lidhur me agjendën gjeopolitike të BE-së, Borrelli përmendi edhe takimet e ndara me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, më 16 shkurt dhe me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq. "Me presidentin e Serbisë, Vuçiq, dhe kryeministrin e Kosovës, Kurti, diskutova, në takime të ndara, se si të shtensionohet situata mes dy shteteve por, fatkeqësisht, pa sukses", tha Borrell.

Tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë rritur pasi që nga 1 shkurti ka nisur të zbatohet një rregullorë e Bankës Qendrore të Kosovës që parashihet euron si valutën e vetme për kryerjen e pagesave me para të gatshme, duke ndaluar dinarin serb. Bashkimi Evropian po kërkon që kjo çështje të zgjidhet përmes



dialogut, por Kosova ka thënë se rregullorja e BQK-së nuk është temë e dialogut.

Shtetet e Bashkuara, ndërkaq, po kërkojnë që Kosova ta shtyjë zbatimin e këtij vendimi, pasi ka argumentuar se ai është marrë pa konsultime paraprake dhe pa

pasur për bazë ndikimet negative të popullata serbe në Kosovë. Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre në dinarë - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

Pas takimit në Munih, nga Zyra e

Kurtit tha se me Borrellin dhe me të dërguarin e BE-së, Miroslav Lajçak, është biseduar për deklaratat e zyrtarëve serbë sa i përket Marrëveshjes në rrugën drejt normalizimit të raporteve. "Në dritën e shkeljeve të vazhdueshme nga Serbia, sulmit

terrorist dhe paramilitar në Banjskë ndaj integritetit territorial të Kosovës dhe sigurisë kombëtare, letrave dhe deklaratave të vazhdueshme publike për mosdetyrimin ligjor të marrëveshjes për Serbinë dhe për moszbatimin e plotë të Marrëveshjes Bazike të arritur në Bruksel dhe Aneksit të saj në Ohër, nënshkrimi i marrëveshjeve është bërë i nevojshëm si garanci e respektimit dhe zbatimit të plotë të tyre, drejt normalizimit të plotë të marrëdhënieve ndërmjet dy vendeve", tha Kurti, sipas njoftimit.

Bashkimi Evropian ka thënë se Marrëveshja në rrugën drejt normalizimit të raporteve, që është arritur vitin e kaluar, nuk ka nisur të zbatohet.

Marrëveshja prej 11 nënesh, ndër të tjera, parashihet edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi që t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të arritura gjatë dialogut.

## Betohet anëtari i ri i KPK-së nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë



PRISHTINË, 26 SHKURT - Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Ardan Hajdaraj, ka mbajtur takimin e 243-të me radhë, në të cilin janë diskutuar dhe miratuar pikat sipas rendit të ditës.

Në fillim të takimit është betuar anëtari i ri i Këshillit Prokurorial,

profesor Dardan Vuniqi, i cili është zgjedhur nga radhët e profesorëve universitarë të drejtësisë, me ç'rast kryesuesi Hajdaraj i uroi mirëseardhje, duke i dëshiruar punë të suksesshme në mandatin e tij. Gjatë takimit KPK-ja mori edhe këto vendime. Mirato

Plotësimin dhe Ndryshimin e Vendimit KPK/nr.148/2024 për themelimin e Komisionit për zgjedhjen e Anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga Prokuroria Speciale, kryesuesi i të cilit u zgjodh Dardan Vuniqi, siç parashihet ligji që duhet të jetë anëtar joprokuror. Emëroi

anëtarin e Këshillit Drejtues në Akademinë e Drejtësisë nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, drejtorin e Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi, i cili do të ketë mandat katërvjeçar. Aprovoi kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prishtinës për

vlerësimin e jashtëzakonshëm të një prokurori nga e njëjta prokurori. Refuzoi raportin e Panelit hetimor ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, si dhe mori vendim që i njëjti të trajtohet nga Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve.

## Konjufca shpallet i pafajshëm për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend

PRISHTINË, 26 SHKURT - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin lirues ndaj kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i akuzuar për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvend.

Aktgjykimimi ndaj Konjufcës është shpallur të hënën nga gjykatësja Edita Çanta. Kryetarja e trupit gjykues, Edita Çanta, ka thënë se

përgjatë procesit gjyqësor nuk është vërtetuar që Konjufca, sa ishte deputet opozitar, e ka kryer veprën penale për të cilën e akuzon Prokuroria Themelore në Prishtinë.

Aktakuza për këtë rast ishte ngritur më 2017 dhe përmbante edhe akuzën për veprën penale pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare, mirëpo

ndjekja për këtë veprë penale është parashkruar vitin e kaluar.

Në mbledhjen e vitit 2016 ku u hodh gaz lotsjellës në rend dite ishte futja në agjendë legjislative e Marrëveshjes për Demarkacionin e Kufirit me Malin e Zi.

Në paraqitjen e mbrojtjes, Konjufca është mbrojtur në heshtje.





MANIFESTIM MADHËSHTOR ME BASHKATDHESTARË NË AARGAU TË ZVICRËS

## Kryetari i Degës së PDK-së në Zvicër thotë se mijëra bashkatdhetarë i janë bashkuar vizionit të PDK-së

Dega e Partisë Demokratike të Kosovës në Zvicër ka organizuar shënimin e 16-vjetorit të Pavarësisë në kantonin Aargau. Kryetari i kësaj dege, Ragip Xhaka, ka theksuar se prej që është organizuar shtrirja e PDK-së nëpër kantonet zvicerane, me mijëra bashkatdhetarë i janë bashkuar vizionit të PDK-së. Ai i ka ftuar bashkatdhetarët të bëhen pjesë e rrugëtimit të PDK-së për ta sjellë ndryshimin e kërkuar në Kosovë. E kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili së bashku me bashkëpartiakë ishte i pranishëm në këtë organizim, ka thënë se mërgimtarët janë katalizatori i secilit zhvillim të rëndësishëm në historinë e vendit tonë

EPOKA  
ERE

Sadik ZEQRIRI

AARGAU, 26 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, së bashku me shumë zyrtarë tjerë të partisë,

kanë marrë pjesë në shënimin e 16-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës në Aargau, që është organizuar nga Dega e PDK-së në Zvicër.

Gjatë këtij manifestimi Krasniqi tha se mërgimtarët janë shtylla e

kombit dhe e shtetit tonë, edhe pse të shpërndarë në mbarë globin. "Edhe pse larg atdheut, ju keni sakrifikuar gjithçka për të mbajtur gjallë ëndrrën për liri, pavarësi dhe shtetndërtim. Sot unë qëndroj me krenari përkrah

emigrantëve tanë të suksesshëm në çdo cep të botës - individëve që i kanë sjellë nder dhe lavdi emrit të Kosovës dhe kombit shqiptar përmes punës së paepur dhe suksesit maksimal. Të gjithë, pa përjashtim, me mburrje thonë se janë nga Kosova: nga Granit e Taulant Xhaka, Xherdan Shaqiri e deri te Dua Lipa dhe Rita Ora. Kjo është krenari dhe këtë askush nuk mund të na marrë", ka thënë Krasniqi.

Më tej, ai ka shtuar se mërgimtarët janë katalizatori i secilit zhvillim të rëndësishëm në historinë e vendit tonë. Dhe, si të tillë, ata janë pjesë përbërëse, e pandashme dhe tejet e nevojshme edhe për të ardhmen

evropiane të Kosovës. "Prandaj, përfshirja juaj në jetën politike dhe kontributi juaj i drejtpërdrejtë është i domosdoshëm. Unë që sot dëshiroj t'ju them se në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, që priten të mbahen këtë vit, PDK jo vetëm që do të kandidojë përfaqësues të degëve tona nga mërgata, duke filluar këtu nga Zvicra, por jam i bindur se edhe do t'i kemi përfaqësuesit tuaj si deputetë në Kuvendin e Republikës së Kosovës", ka theksuar Krasniqi, duke shtuar se Kosova ka nevojë për mërgimtarët. "Dhe ne jemi mirënjohës për punën tuaj të madhe", tha ai.



**“Në festën tonë po mungojnë ata që do të duhej të ishin në ballë të shënimit të kësaj dite...”**

Në këtë përvjetor të pavarësisë, lideri i PDK-së ka përmendur edhe mungesën e madhe të burrështetasve, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe shokëve të tyre. “Nuk është e plotë, sepse në festën tonë po mungojnë ata që do të duhej të ishin në ballë të shënimit të kësaj dite - çlirimtarët e vendit tonë, më meritoret e shtetit tonë, shpallësi i pavarësisë Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe shokët e tyre. Po mungojnë, padrejtësisht, ata të cilët një jetë ia kushtuan luftës për liri, pavarësi dhe shtetndërtim të Kosovës. Prandaj, nga këtu, nga ky tubim madhështor, edhe sot u dërgojmë përshëndetjet tona më të ndjera heronjve tanë në Hagë, të cilët me guxim dhe vendosmëri po zhvillojnë betejën e fundit për ta dëshmuar



dëshpërimin, e prangosur nga zinxhirët e paaftësisë dhe papërgjegjshmërisë së një qeverie të korruptuar në shpirt infrastrukturën, kulturën, mjedisin dhe cilindo sektor tjetër. Më shumë se tri vjet në pushtet, asnjë projekt serioz dhe i madh Kosovën e presin ditë më të mira - për këtë jam i sigurt. Por, nuk mjafton thjesht të shpresojmë për ndryshim; ne duhet të punojmë

në mënyrë aktive për ta realizuar atë. Është detyrë e çdo qytetari, brenda dhe jashtë vendit, të kërkojë llogari, të përpiqet për prosperitet dhe të punojë pa u lodhur për të ardhmen e vendit tonë. Së bashku nuk guxojmë dhe nuk do të lejojmë që sakrificat e të parëve tanë të shkojnë dëm. Politikanët dhe qeveritë e papërgjegjshme janë të përkohshme, por Kosova jonë është e përjetshme”, ka përfunduar Krasniqi.

**“Puna drejt rritjes dhe fuqizimit të PDK-së në Zvicër do të vazhdojë”**

Të pranishmit i përshëndeti edhe kryetari i Degës së PDK-së në Zvicër, Ragip Xhaka, i cili tregoi se prej që është organizuar shtrirja e PDK-së nëpër kantonet zvicerane, me mijëra bashkatdhetarë i janë bashkuar vizionit të PDK-së. Kryetari i Degës së PDK-së në



pastërtinë dhe drejtësinë e luftës së popullit tonë për liri”, ka thënë kryetari Krasniqi.

**“Kosova jonë e gjen veten të zhytur në thellësitë e dëshpërimit nga një qeveri e korruptuar”**

Lideri i PDK-së shtoi se së bashku duhet të festojmë jo vetëm triumfet e së kaluarës sonë, por edhe duhet të përballemi me realitetet e zymta që e përcaktojnë të tashmen tonë. “Kosova jonë e dashur, vendi ynë i shpresës dhe i lirisë, e gjen veten të zhytur në thellësitë e

dhe pa ideale kombëtare. Qeveria jonë, e ngarkuar me detyrën e shenjtë për t’u shërbyer interesave të popullit, ka dështuar mjerisht. Nëpërmjet veprimeve të saj ajo ka vënë në rrezik edhe marrëdhëniet tona të fituara me vështirësi me aleatët tanë ndërkombëtarë, duke na lënë të izoluar në skenën botërore”, ka thënë kryetari Krasniqi. Ai ka thënë se pasojat e veprimeve të kësaj qeverie shtrihen shumë përtej sferës së diplomacisë. “Ata po u shkaktajnë vuajtje të panumërta qytetarëve tanë, duke rrënuar ekonominë, shëndetësinë, arsimin,



Zvicër tha se puna drejt rritjes dhe fuqizimit të PDK-së do të vazhdojë me përkushtim gjatë gjithë kohës, andaj edhe i ftoi të gjithë mërgimtarët të bëhen pjesë e rrugëtimit për ta sjellë ndryshimin e kërkuar në Kosovë. Në këtë aktivitet morën pjesë mbi një mijë mërgimtarë, nga të gjitha sferat, përfshirë edhe zyrtarë të të gjitha niveleve të Partisë Demokratike të Kosovës. Të pranishmit i përshëndetën me një fjalë edhe deputeti Elmi Reçica, kryetar i Komisionit për Organizimin e PDK-së në Mërgatë, si dhe Arbnora Salhiu, kryetare e Rinisë Demokratike të Kosovës.



për vendin tonë nuk është realizuar nga kjo qeveri. Fatkeqësisht, sot Kosova dhe qytetarët e saj janë në dëshpërim”, ka deklaruar Krasniqi. Megjithatë, ai shtoi se është detyrë e jona, si parti shtetformuese dhe shtetndërtuese, që ta nxjerrim vendin tonë nga kjo gjendje. “Përballë këtij degradimi ne nuk duhet ta humbasim shpresën - ashtu siç nuk e kemi humbur as para luftës dhe as pas saj. Edhe në orën tonë më të errët, mbetet një fije besimi që premtion një të nesërme më të mirë. Sepse



## Kurti nënshkruan marrëveshje prej 400 milionë eurosh me BERZh-in

PRISHTINË, 26 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se ka nënshkruar marrëveshje me Bankën Evropian për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) për investime 400 milionë euro në sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit. Kurti ka

theksuar se kjo shifër është më e madhe se totali i 340 milionë eurove në kredi dhe grante sovraane të marra gjatë tërë 11 viteve që Kosova është anëtare e kësaj organizate. "Partneriteti me BERZh-in është më i fortë se kurrë. Sapo kam nënshkruar një memorandum të

marrëveshjes me presidenten Odile Renaud për 400 milionë euro investime në sektorët kryesorë për periudhën 2024-27, më shumë se 340 milionë euro në kredi dhe grante sovraane gjatë tërë 11 viteve që Kosova është bërë shtet anëtar", ka shkruar Kurti në platformën "X".



## BE-ja konfirmon pjesëmarrjen e Kosovës dhe Serbisë në takimin për dinarin

PRISHTINË, 26 SHKURT - Bashkimi Evropian ka konfirmuar pjesëmarrjen e delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë në një takim në Bruksel më 27 shkurt për çështjen e ndalimit të dinarit në Kosovë.

Nga Kosova konfirmuan për "Radion Evropa e Lirë" se ftesës së BE-së i është përgjigjur pozitivisht Banka Qendrore e Kosovës, pa dhënë emra se kush do të jetë pjesë e delegacionit. Por, "Radio Evropa e Lirë" merr vesh se Kosova në takim do të përfaqësohet nga guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili. Ndërkaq, sipas medieve serbe, në takimin e 27 shkurtit Serbinë do ta përfaqësojë kryenegociatori serb në dialogun Kosovë - Serbi, Petar Petković.

BQK-ja tha se edhe më herët ka shprehur gatishmërinë të takohet me përfaqësuesit e Bankës Popullore të Serbisë, për ta lehtësuar transferimin e parave, përmes kanaleve bankare, pas hyrjes në fuqi të rregullores së saj më 1 shkurt, e cila parasheh që vetëm euroja të jetë valuta për pagesa me para të gatshme. "Në këtë kuptim, [BQK-ja] edhe u përgjigjet ftesave kur janë të



nevojshme, për takime të tilla informuese, siç edhe ka bërë në vazhdimësi edhe me prezencën ndërkombëtare në vend", u tha në përgjigjen e BQK-së dërguar "REL"-it.

Ndërkaq, zëdhënësja e Komisionit Evropian për çështje të politikës së jashtme, Nabila

Massrali, nuk saktësoi se kush do të marrë pjesë, por tha se takimi do të jetë "në formatin e zakonshëm të dialogut" dhe në të do të flitet për "gjetjen e zgjidhjeve".

Javën e kaluar kryenegociatori i Kosovës në dialog, Besnik Bislimi, ka deklaruar se nuk do të marrë

pjesë në takim, duke e akuzuar të dërguarin evropian për dialogun, Miroslav Lajčak, se ka shkelur parimin e caktimit të agjendës së takimit, pa pajtimin e palëve. "Ajo që unë mund të them është se po, do të kemi takim nesër. Takimi i nesërm është takim i dialogut, i cili do të fokusohet në zgjidhjet e

çështjeve të hapura lidhur me vendimet e fundit për qarkullimin e valutave nga BQK-ja", tha Masralli.

Sipas BE-së, takimi do të nisë në mëngjes dhe do ta ketë rrjedhën e njëjtë të takimeve në formatin e zakonshëm të dialogut. "Dhe po, të dyja palët kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre", tha zëdhënësja duke shtuar se detajet për takimin do të jepen më vonë. Bashkimi Evropian po kërkon që çështja e ndalimit të dinarit serb të zgjidhet përmes dialogut.

Shtetet e Bashkuara, ndërkaq, po kërkojnë që Kosova ta shtyjë zbatimin e këtij vendimi, pasi ka argumentuar se ai është marrë pa konsultime paraprake dhe pa pasur për bazë ndikimet negative të popullata serbe në Kosovë.

Autoritetet në Kosovë kanë thënë se rregullorja do të zbatohet përmes një tranzicioni të lehtësuar, jo më të gjatë se tre muaj, ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka insistuar se vendimi nuk do të zhbëhet.

Shteti serb ndan miliona euro për serbët në Kosovë pasi ua paguan atyre në dinarë - përmes një sistemi paralel - rrogat, pensionet dhe ndihmën shtesë.

## KEDS-i zgjidh problemin për shumë dekada në një nga fshatrat me sipërfaqen më të madhe në Kosovë

Prishtinë, 26 shkurt - Rrjeti i vjetër, tensioni i ulët, shtyllat elektrike, nuk do të jenë më problem për banorët e fshatit Komogllavë të Ferizajt, që llogaritet një nga fshatrat më të mëdha në Kosovë për nga sipërfaqja.

Me punimet në rrjetin energjetik në tensionin e ulët dhe të mesëm, që tashmë kanë mbërritur në fazën e fundit, do të rriten kapacitetet energjetike në këto anë dhe do të përmbushen të gjitha nevojat e banorëve.

KEDS-i këtu ka vendosur dy trafo, njëra me kapacitet prej 400 KVA, tjetra 160 KVA, një trafo shtyllë dhe shumë shtylla të betonit e mijëra metra kablo elektrike. Mbi 150 mijë euro llogaritet të jetë kostoja e këtij projekti, ku përfitues do të jenë 180 konsumatorë, por në mënyrë indirekte kanë përfituar shumë konsumatorë të tjerë të fshatrave përreth. Këtij ndryshimi i gëzohen banorët

e kësaj ane dhe falënderojnë KEDS-in për punët e bëra këtu.

Enver Salihu nga lagja Tafali thotë se ka 60 vjet që këtu s'ka pasur asnjë investim në rrjetin energjetik. "Rryma është nevojë elementare dhe tashmë jemi të gëzuar për të mirat që po na vijnë. I jemi mirënjohës kompanisë KEDS", thotë Salihu. KEDS-i vazhdon të investojë sipas planit të paraparë zhvillimor në rrjetin distributiv për të gjithë konsumatorët anekënd vendit. "Për 10 vjet të ekzistencës, kompania ka investuar anekënd territorit të vendit mbi 216 milionë euro për përmirësimin e rrjetit distributiv të energjisë elektrike. Këto investime nuk po ndalen as tash kur jemi në vitin e 11-të të operimeve. Këto investime po bëhen me qëllim që konsumatorët të kenë shërbime sa më kualitative dhe të sigurta", ka njoftuar KEDS-i.





# Arti si luftë: Realiteti surreal i Ukrainës



**Nga: Charlotte Higgins / The Guardian (titulli original: *Art shows the surreal reality of wartime Ukraine in a way the news never could*)**

**Përkthimi: Telegrafi.com**

Lufta e Rusisë kundër Ukrainës nuk ka qenë kurrë vetëm për territorin dhe artilerinë, për politikanët dhe marrëveshjet e supozuara të paqes. Sigurisht, kjo është mënyra më e lehtë dhe më e pranueshme me të cilën mund të shpjegohet dhuna e paimagjinueshme: si problem gjeopolitik që ndodh në një distancë të largët. Por, agresioni i Rusisë është ngjarje me përmasa tronditëse, për çdo jetë individuale në Ukrainë dhe për jetën kudo. Lufta nuk po ndodh vetëm në vijën e frontit, por në shtëpi dhe në zemër. Vdekjet vajtohen. Jeta që dikur ishte e drejtpërdrejt u shty në drejtimet që kurrë nuk janë kërkuar apo dashur. Ambiciet janë braktisur dhe planet janë hedhur mënjanë. Lufta ka depërtuar si mjegull në çdo pjesë të jetës shtëpiake, në çështjet e lehta, drithëruese të dashurisë dhe seksit, në ditët e shkollës ku fëmijët e rinj e të gëzuar ukrainas, bashkë me matematikën dhe anglishten marrin mësimet për të mos prekur kurrë diçka që mund të jetë minë.

“Ajo që nuk shohim në titujt e lajmeve, janë bisadat rreth

tryezës së kuzhinës – familjet që diskutojnë, për shembull sa karburant nevojitet nëse papritur duhet të ikin për në Varshavë”, ka thënë javën e kaluar, në një ngjarje, Uilleam Blacker – profesor i asociuar i kulturës së Ukrainas dhe Evropës Lindore në Kolegjin Universitar të Londrës [University College London]. Për t’iu afruar ndjenjës dhe strukturës së luftës, siç jetohej prapa linjave – dhe pas dyerve të përpame – është e nevojshme t’ju drejtohem punës së artistëve, shkrimtarëve, dramaturgëve dhe kineastëve ukrainas. Blacker ishte në bisedë me Natalya Vorozhbitin, një nga dramaturget më të rëndësishme të Ukrainës, dhe Molly Flynnin që është redaktore e një antologjie të re të dramave ukrainase të përkthyer në anglisht e të cilat u shkruan në vazhden e protestave në Maidan – një dekadë më parë. Që atëherë, Ukraina ka përjetuar një lulëzim të teatrit dokumentar, shpeshherë të shpejtë dhe reaktiv, dhe të përqendruar në jetën e zakonshme – vepër që ka formuar një lloj paraleleje artistike me shoqërinë e fuqishme civile të Ukrainës. Shkrimet bazohen në realizëm, por jo gjithmonë në mënyra të pritshme. Drama e Vorozhbitit, *Shasha, hidhi mbeturinat jashtë*, e shkruar në vitin 2014, trajton një familje që përballet me

vdekjen në luftën në Donbas – familjen e Sashës, baba dhe bashkëshort. Shfaqja fillon pas vdekjes së tij; prania e tij është fillimisht një portret në mur. Pastaj ai fillon të flasë: një fantazmë, mund të thoni. Autorja britanike Deborah Levy përshkroi një herë sesi “realiteti” njerëzor nuk konsiston vetëm në botën e jashtme që kryen punët racionale, por në imagjinatën, mendimet dhe fantazitë tona të cilat gjithashtu janë ngjarje reale në jetën tonë. Njëpërmjet ëndrrave tona me sy të hapur dhe njëpërmjet paramendimeve tona mund të udhëtojmë në kohë, të flasim me të vdekurit dhe të na drejtohen të vdekurit. Gjërat e tilla nuk janë materiale të raporteve të esëllta apo buletineve të lajmeve, por janë po aq kuptimplota dhe janë në territor të artit.

Në Kiev, në vjeshtën e kaluar takova një grup të dramaturgëve të cilët debatonin se si mund të shkruajnë në mes të luftës që po zhvillohet në shkallë të gjerë. Në vazhden e menjëhershme të 24 shkurtit 2022, situata ishte ndier si e vështirë dhe ndoshta e parëndësishme për të shkruar, më thanë ata: fokusi ishte se si të mbijetoj. Megjithatë, në muajt që pasuan, pati një përhapje të teatrit dokumentar të bazuar shumë në tregimet reale të historive të arratisjes dhe të mbijetesës. Dhe, vitin e kaluar, më thanë se e zbuluan një kthesë të re në teatrin ukrainas. Disa

dramaturgë e përdornin komedinë në punën e vet, disa fantazinë, disa madje edhe format e fantashkencës. Dramaturgjia Oksana Grytsenko më tha se është duke e shkruar një dramë për statujat e rrëzuara në Ukrainë të shkrimtarit Aleksandër Pushkin – i cili ngjallej për t’iu bashkuar ushtrisë ruse. Kur jeta kthehet në kokë, surrealia dhe metafora mund të ofrojnë të vetmen mënyrë të saktë për ta shprehur një situatë. Në mënyrë të ngjashme po lulëzon edhe poezia në Ukrainë: është mediumi i aftë për të shprehur se si dhuna e shkatërron kuptimin; se si e copëton dhe shkërmoq koherencën e narrativës së jetës së individëve.

Ju mund të mendoni se leximi i një poezie për luftën, shikimi i një piktore ose shikimi i një filmi, mund të jetë disi përvojë dytësore, më pak e drejtpërdrejt dhe më pak udhëzuese sesa, të themi, shikimi i lajmeve. Dyshoj se e kundërta e kësaj është e vërtetë: në duart e një artisti të mirë, mund të zhytesh në jetën e një njeriu tjetër, të zhduken të gjitha distancat, të shemben të gjithë kufijtë. Kjo mund të jetë jashtëzakonisht e dhimbshme, si në dokumentarin fitues të BAFTA-s, *20 ditët në Mariupol*, regjisori i të cilit, Mstyslav Chernov, e fut shikuesin drejt dhe brenda qytetit të rrethuar. Poetja ukrainase Halyna Kruk e shkroi së fundmi një poezi, të cilën Blacker e përktheu javën e kaluar.

Fillon duke marrë parasysh një skenë të tmerrit dhe të vdekjes së fundit. *Duke parë nga larg, gjithmonë mund të ndalesh në kohë, / të mos afroresh shumë, aty ku syri sheh shumë.* Letërsia, shkruan ajo, mund të na çojë drejt pozicionit ku mund t’i thithim ato që përndryshe mund të jenë detaje të padurueshme: *Këpuçet e fëmijës që fluturuan në ajër – nga këmba e fëmijës, / kur përzihen me copat e qelqit dhe betonit, thonjtë e thyer të grave dalin nga rrënojat, / mbetjet e paqarta të trupit.* Poezia mund të ofrojë mënyrën për ta parë një realitet të paqartë, në shkëlqimin e tij të ndritshëm dhe të dhimbshëm, sugjeron Kruk: kufijtë e formës artistike e përmbajnë atë dhe e bëjnë – thjesht – të durueshme për ta parë.

Mendoj shumë për pikturat e buta nga Lucy Ivanovas të cilat muajin e kaluar i pashë në një ekspozitë në *Jam Factory*, në një qendër arti të sapohapur në Lviv. Duke i përdorur mjetet e thjeshta që dispononte – kanavaca të vogla, fletore – ajo i pikturoi skenat më intime: burri i saj Yehor duke kërkuar i lajmet ose duke qëndruar ulur buzë krevatit; të dy lakuriq, ajo shtatzënë, në kuzhinën e një apartamenti të përkohshëm; më vonë djali i saj Sava, pesë ditësh. Këto vepra arti janë gjithashtu dëshmitare të përvojës dhe të bazës së kujtesës kulturore. Edhe kjo është luftë. /Telegrafi/

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Vdes në moshë të re ish-hendbollisti i Vëllaznimit, Argjend Dreshaj

**GJAKOVË, 26 SHKURT** - Federata e Hendbollit e Kosovës ka bërë me dije se të hënën ka vdekur Argjend Dreshaj, ish-hendbollisti i Vëllaznimit të Gjakovës. Në njoftimin e lëshuar thuhet se i ndjeri është përbullur

me një sëmundje të rëndë për disa vjet. "Dreshaj ishte i lindur në vitin 1989, ndërsa ishte pjesë e të gjitha grupmohave të reja të Vëllaznimit të Gjakovës. Ka luajtur me sukses për periudhë të gjatë edhe për ekipin senior,

ndërsa është shquar për urtësinë dhe respektin ndaj të tjerëve. Në vitet e fundit i ndjeri Dreshaj ka jetuar jashtë vendit. Në emër të Federatës së Hendbollit të Kosovës dhe të familjes kosovare të hendbollit, familjes së

respektuar Dreshaj, klubit të hendbollit Vëllaznimi dhe gjithë komunitetit të hendbollit në Gjakovë ngushëllimet më të thella ia shpreh presidenti Eugen Saraçini", thuhet në njoftim e FHK-së.



## Ferati: Synojmë kualifikimin në Botëror



**PRISHTINË, 26 SHKURT** - Përfaqësuesja U18 e Kosovës në hendboll (vajzat) ka udhëtuar në Tashkent të Uzbekistanit. Në Uzbekistan, Kosova do të paraqitet në IHF Trophy Intercontinental që mbahet prej 28 shkurtit deri më 3 mars. Finalistët kualifikohen në Kampionatin Botëror që mbahet në verë. Kosova U18 është grumbulluar më 21 shkurt, ndërsa gjatë fazës përgatitore i ka luajtur tri ndeshje stërvitore. Kosova U18 është në grup me Guatemalën dhe Uzbekistanin. Në grupin tjetër janë Guadalupe, Kaledonia e Re dhe Nigeria. Më 29 shkurt Kosova luan me Uzbekistanin. Më 1 mars është ndeshja me Guatemalën. Më 2 mars janë ndeshjet gjysmëfinale dhe ndeshja për vend të pestë. Ndërsa ndeshja për vend të tretë dhe finalja janë më 3 mars.

Kryetrajneri i Kosovës U18, Mitat Ferati, është i kënaqur me gjendjen e Përfaqësueses. "Përgatitjet ishin shumë të mira. I kemi luajtur tri ndeshje që na kanë shërbyer shumë. Është me shumë rëndësi që gjatë përgatitjeve nuk kemi pasur ndonjë lëndim. Na mungojnë vetëm vajzat që nuk kanë mundur të grumbullohen fare. Në përgjithësi jam i kënaqur me gjendjen e ekipit", ka thënë Ferati. Ai ka konfirmuar ambiciet e mëdha. "Qëllimi është të sigurojmë kualifikimin në Botëror, natyrisht. Shkojmë për t'i fituar të gjitha ndeshjet. Jemi prej favoritëve dhe këtë duhet ta konfirmojmë me lojëra të mira. Natyrisht ndeshja e parë është shumë e rëndësishme për motivimin e ekipit. Shpresojmë të nisim mbarë dhe të vazhdojmë deri në fund", ka shtuar Ferati.

## Hazrollaj për herë të dytë rrëmben çmimin 'Ylli i javës': Uroj t'i arrijmë objektivat

**MALISHEVË, 26 SHKURT** - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ndarjen e çmimit "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 22-të në Albi Mall Superligë i ka takuar futbollistit të FC Malisheva, Drilon Hazrollaj. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Isuf Llumnica, Fatmir Mehmeti dhe Arton Hajdari. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e 22-të t'i takojë Drilon Hazrollajt, pasi ai ishte përcaktues në fitoren e Malishevës kundër Feronikelit 74, 2:1, me dy gola të shënuara (78', 89'). Ai njëherësh, përkundër moshës së re, është futbollist që

merr guximin për të qenë lider dhe ndër më të merituarit për serinë e suksesshme të skuadrës së tij. Çmimin "Ylli i javës" për futbollistin e FC Malisheva, Drilon Hazrollaj, e dha Makfire Bllaca Kyçyku, menaxhere e blerjes në Albi Mall. Pasi mori këtë çmim futbollisti i Malishevës u shpreh i lumtur për vlerësimin. "Ndihem i lumtur. Ky është çmimi i dytë për mua. Falënderoj bashkëlojtarët dhe shtabin teknik, pasi me ndihmën e tyre arrita të kem një performancë të mirë. Uroj që edhe në vazhdim të kampionatit të kemi një ecuri pozitive si ekip dhe t'i arrijmë objektivat", ka thënë Hazrollaj për faqen zyrtare të FFK-së.




## Pesëshja e javës në Superligën e Femrave

**Prishtinë, 26 shkurt** - Gjatë fundjavës është zhvilluar xhironja e 19 në Superligën e Femrave. Derbi i javës takoi dy rivalët e vjetër, Prishtinën dhe Bashkimin. Bashkimi arriti fitore të rëndësishme në kryeqytet 61:80. Për këtë

fitore lojtaret më efikase ishin Sarah Mgbeike 28 pikë, 13 kërcime dhe 4 asistime si dhe Arbnore Përçuku me 15 pikë, 8 kërcime 11 asistime. Ballafaqimi në mes të Penzes dhe Trepçës i takoi Penzes me rezultat 82:78 kështu

duke iu afruar play off-it edhe më shumë. Peevy Lucia Elise me 26 pikë e 10 kërcime e cila u ndihmua nga Saranda Daci me 12 pikë, 8 kërcime dhe 7 asistime. Java e 19 u mbyll me ndeshjen në mes të Peja 03 dhe United Basketball me

rezultat 95:62. Te Peja 03 lojtarja më e dalluar ishte Jenna Mastellone 23 pikë, 10 kërcime dhe 5 asistime. Në këtë fundjavë zhvillohet xhironja e 20 e cila është edhe xhironja e fundit e edicionit të rregullt.



## LeBron James paralajmëron pensionimin

Los Anxhelos, 26 shkurt - LeBron James mund ta shqyrtojë mundësinë e pensionimit nga basketbolli. Ky lajm i ka tronditur adhuruesit e basketbollit. Në konferencën pas "All Star Game" 2024, bëri të qartë se

ai ende nuk ka ide të qarta për të ardhmen e tij, por në të njëjtën kohë ai la të kuptohet se mundësia e pensionit është në tavolinë. "Nuk e di se kur do të vijë fundi, por po vjen", ka thënë LeBron James, i cili për këtë arsye pranon se po

mendon të tërhiqet. James në tavolinë i ka disa opsione, ka nga ata që thonë se do ta rinovojë kontratën me Lakersin, të tjerë janë të bindur se LeBroni do të bëhet lojtar i lirë dhe për këtë arsye do të kërkojë një ekip të ri.

Megjithatë, nuk mund të përjashtohet që të vendosë t'i thotë mjaft basketbollit dhe NBA-së. LeBron Jamesi synon të jetë i pranishëm me USA-n në Olimpiadën e Parisit 2024, por shumë do të varet nga gjendja e tij fizike.



## Verstappen: Kjo makinë bën gjithçka që dua, është më e mirë se e vitit të kaluar

MILTON KEYNES, 26 SHKURT - "Makina bën gjithçka që dua dhe në këtë aspekt është më e mirë se RB19". Këto fjalë, të shqiptuara të hënën nga piloti holandez i Red Bull Racing, Max Verstappen, rrezikojnë të bëhen refreni i një kampionati që mund t'i ngajë shumë atij të një sezoni më parë në Formula 1. Makina austriake nuk ishte më e shpejtë në pistë në testet e Bahreinit, por kjo edhe për faktin se nuk përdori gomat e buta. Tri herë kampioni i botës, duke vazhduar analizën e tij të testeve, theksoi se nuk kishte punuar për ta kërkuar xhiron e shpejtë. "Në përgjithësi testet ishin shumë pozitive. Ne u fokusuam në periudhat e gjata për të kuptuar më mirë makinën dhe ishte mirë të shihje se performanca e makinës ishte shumë e fortë. Ne vendosëm të mos fokusohemi në kohën e shpejtë të xhiros, por të provojmë pjesë të ndryshme, kështu që jam i



kënaqur me xhirot që bëme", ka thënë Verstappen. "Në funksion të fundjavës së garës, ka të bëjë me rregullimin e makinës dhe të shohim se çfarë na ofron gara kur e shtyjmë makinën në kufi. Tani duhet të analizojmë më mirë të dhënat dhe të përpiqemi të nxjerrim një plan për javën në

vazhdim", u shpreh holandezi. "Testet ishin shumë pozitive dhe ne mësuam shumë nga të gjitha ndryshimet që bëme, kështu që mezi presim këtë fundjavë kur të zhvillohet gara e parë sezonale", ka shtuar Verstappen, duke paralajmëruar rivalët se edhe këtë vit mund të jetë i pakapshëm.

## Triumfon Milwaukee, Denveri 'leksion' Golden States

PHILADELPHIA, 26 SHKURT - Denveri e mposhti me rezultat 119-103 Golden States, një përballje mes ekipesh pretendente në Konferencën e Perëndimit. Niola Jokiqi, protagonist me një "triple double" (32 pikë, 16 rebounde, 16 asistime), duke i dhuruar fitoren ekipit kampion, mbështetur edhe nga Murray me 27 pikë. Phoenixi,



falë një loje të mirë kolektive (4 lojtarë realizuan mbi 20 pikë), mposhti me rezultat 123-113 lakersat, ndërsa Sacramento mposhti me rezultat 123-107 ekipin tjetër të Los Anxhelosit, atë të Clippersit. Për Sacramenton u dallua De'Aron Fox, autor i 33

pikëve. Pa problem fitoi Milwaukee, që mundi me shifrat 119-98 Philadelphia, sfidë ku diferencën e bëri Antetokounmpo, me 30 pikë e 12 rebounde. Fitoi edhe Oklahoma, që mundi me rezultat 123-110 Houstonin, sfidë ku Shai realizoi 36 pikë.

### REZULTATET

Philadelphia - Milwaukee	98-119
Phoenix - Lakers	123-113
Indiana - Dallas	133-111
Washington - Cleveland	105-114
Golden State - Denver	103-119
New Orleans - Chicago	106-114
Houston - Oklahoma	110-123
Atlanta - Orlando	109-92
Utah Jazz - San Antonio	128-109
Portland - Charlotte	80-93
Clippers - Sacramento	107-123

## Infantino: Krenar me atë që po i jap futbollit

"Jam vërtet krenar që kam mbushur tetë vjet si president i FIFA-s dhe jam jashtëzakonisht mirënjohës për të gjithë ata që kanë qenë pjesë e këtij rrugëtimi deri më sot". Këtë e ka nënvizuar presidenti i organizmit kryesor

botëror të futbollit, Gianni Infantino, në përvjetorin e zgjedhjes së tij të parë. "Kur mora detyrën, misioni im ishte ta bëja futbollin global, të aksesueshëm, të sigurt dhe një vend mikpritës për të gjithë, me FIFA-n si pikën

kryesore të kësaj lëvizjeje. Thashë se do ta ktheja futbollin në FIFA dhe FIFA-n në futboll dhe mbajta fjalën time", nënvizoi menaxheri zviceran në rrjetet sociale. "Edhe pse puna jonë nuk ndalet kurrë, kam kënaqësinë të ndaj se kemi

bërë përparim të rëndësishëm në përmirësimin e shëndetit të lojës sonë të bukur në mbarë botën. Sot kjo është një mundësi për mua për ta parë suksesin e tetë viteve të fundit dhe për të marrë një moment për të njohur

përgjegjësinë e madhe që kam për të vazhduar të punoj në emër të të gjithëve dhe për të zhvilluar më tej lojën tonë të bukur. Faleminderit dhe pres me padurim ta mbështes FIFA-n dhe futbollin në vitet në vijim!", ka nënvizuar Infantino.

### SHKURT

#### Mediet në Kroaci: Modriqi mund të rikthehet te Dinamo Zagrebi

Luka Modriqi nuk ka ndër mend të lërë futbollin në qershor. Për këtë arsye ai nuk pranoi propozimin e Carlo Ancelottit, përkatësisht për t'iu bashkuar stafit të trajnerit italian. Sipas medieve kroate, 38-vjeçari mund të kthehet në vendlindje për ta veshur fanellën e Dinamo Zagrebit, klub në të cilin shpërtheu ylli i Kroacisë. Megjithatë, nuk mungojnë ofertat nga klubet saudite dhe amerikane për mesfushorin e Real Madridit.

#### Enrique: Duhet të mësohemi të luajmë pa Mbappen

Luis Enrique i befasoi të gjithë ditën e diel duke larguar nga fusha Kylian Mbappen në minutën e 65-të të lojës, me rezultatin 1-0 në favor të Rennes. Sulmuesi francez u rikthye në formacionin fillestar në Ligën 1 pasi ishte zëvendësues kundër Nantes në ndeshjen e fundit. Në një konferencë për shtyp, Enrique u pyet për arsyen e zëvendësimit të yllit të PSG-së, për të cilën spanjoli u përgjigj: "Herët a vonë kjo do të ndodhë. Në një moment do të duhet të mësohemi të luajmë pa Kylian. Kur ta shoh të përshtatshme, do të vendos se kur do të luajë dhe kur nuk do të luajë, siç bëjnë të gjithë trajnerët. Unë dua konkurrencë maksimale për sezonin e ardhshëm. Dua që të gjithë lojtarët e rinj të PSG-së të mendojnë se kjo është një mundësi e madhe. Kjo është ajo që unë kërkoj këtë sezon dhe sezonin e ardhshëm".

#### Daviesi arrin marrëveshje personale me Realin

Gazetari i njohur gjerman i merkatos, Florian Plettenberg, ka njoftuar se Real Madridi po punon për një tjetër transferim të madh. Pas marrëveshjes për Kylian Mbappen, klubi spanjoll është afër ta përfundojë transferimin e mbrojtësit të majtë të Bayern Munchenit, Alphonso Davies. Siç ka bërë me dije Plettenberg, tashmë janë rënë dakord për kushtet personale të kontratës së Daviesit me Real Madridin dhe nuk pritet që Bayerni të bëjë rezistencë. Shifra e operacionit pritet të jetë maksimalisht 50 milionë euro, pasi Davies po hyn në vitin e fundit të kontratës së tij. Më parë anësori kanadez ka refuzuar rinovimin e kontratës me bavarezët.

#### Inzaghi: Ende nuk jam i qetë për titull

Fitorja 0-4 ndaj Lecces, edhe pse është e dhjeta radhazi në kampionat dhe distanca me Juventusin është e madhe nuk e bëjnë të qetë trajnerin Simone Inzaghi. Numri një i zikaltërve thotë se ekipi duhet të vazhdojë të punojë sepse ka ende mundësi për t'u përmirësuar. "Sigurisht që mund të përmirësohemi sepse tani janë muajt më vendimtarë për ta mbyllur sezonin. Është normale të jemi të lumtur sepse rrugëtimi është pozitiv, por tani është Atalanta. Nuk e konsideroj si një finale për titullin. Kemi nevojë për të gjithë për të vazhduar", ka thënë Inzaghi. "Titulli? Sigurisht që nuk jam aspak i qetë. Ka shumë ndeshje dhe shumë pikë në dispozicion të të gjitha skuadrave. Blin pati një mundësi të mirë dhe duhet ta mbyllim. Na duhet të shpenzojmë shumë energji në të gjitha aspektet. Sanchez tregoi se është një lojtar i madh. Gjithmonë prezent dhe i gatshëm për ta dhënë maksimumin. Lautaro? I kam thënë që të jetë i qetë dhe ta vazhdojë rrugëtimin pozitiv. Një lojtar që gjithmonë kërkon maksimumin nga skuadra dhe nga vetja", ka shtuar Inzaghi.



## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr. 256/1

Datë: 26.02.2024

Bazuar në nenin 2 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Zyrtar Publik Nr. 08/L-197, nenin 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësit e Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPAR-së, shpallë këtë:

### K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur

I. Titulli i vendit të punës: Drejtor i Qendrës të Kompetencës

Qendra e Kompetencës në Ferizaj;

Lloji i Vendit të Punës: Me afat të caktuar, me orar të plotë

Numri i Pozitave: Një (1) pozitë

Kategoria Funktionale: Nivel drejtues

Lloj pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik

Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet

Qëllimi i vendit të punës:

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

#### DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :

- Menaxhimin dhe administrimin e përgjithshëm të institucionit;
- Hartimin e planit vjetor të punës dhe planin zhvillimor të institucionit arsimor dhe raportet vjetore të punës;
- Përdorimin efikas dhe efektiv të sistemit për menaxhimin e informatave në arsim dhe respektimin e kodeve të këtij sistemi, procedurave të sigurimeve dhe afateve të përcaktuara për përditësimin e të dhënave të nevojshme gjatë vitit shkollor;
- Detyrat e caktuara për përzgjedhjen e mësimdhënësve, vlerësimin, disiplinën në institucionin edukativo-arsimor dhe çështje tjera që kanë të bëjnë me mësimdhënësit dhe punëtorët tjerë në arsim;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kurrikulës;
- Mbështetjen dhe mbikëqyrjen e punës së aktiveve dhe bashkëpunëtorëve profesional të institucionit edukativo-arsimor, si dhe mekanizmeve tjera të institucionit arsimor që kanë rol në vlerësimin e performancës dhe menaxhimin e cilësisë së punës së institucionit;
- Bashkëpunon me këshillin drejtues të institucionit edukativo- arsimor (KDSH), Këshillin e Prindërve, Këshillin e Arsimitarëve, Këshillin e Nxënësve dhe komunitetin e institucionit edukativo- arsimor;
- Raporton se paku dy herë në vit para KDSH;
- Siguron ambient të sigurt dhe përkrahës për fëmijët/nxënësit duke përfshirë edhe caktimin dhe aplikimin e masave disiplinore ndaj nxënësve, sipas legjislacionit në fuqi;
- Ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave, siç parashihet nga komuna apo Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASHTI);
- Çështjet e tjera që rregullohen përmes ligjit për arsim parauniversitar, akteve nënligjore të miratuara nga MASHTI;

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendës drejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

#### Kushtet:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimor (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësit sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësit;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;

- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

#### Dokumentet e kërkuara:

- Diplomat e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësit ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënues për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

#### Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatës

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, Planin Zhvillimor të institucionit mund ta merrni në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

#### Vegëzat elektronike

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë të gjithë kandidatët që t'i lexojnë me kujdes të gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

**Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020** për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dheperjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dheaftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

**Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020** - perfshirën Forumularet të cilat janë kyç për përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendës drejtor të IEAAP në bazë të dëshmimeve të prezantuara me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokoll i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-perdrejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-iaa/>

**Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015-** Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimitprofesional/>

#### Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga data e publikimit nga dt. 26.02.2024 deri me dt. 26.03.2024

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Adresa: Rruga “Agim Ramadani” 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAAPARr-së.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen, përveç diplomave të noterizuara.

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuar nga MASHTI;

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentet tjera të nevojshme të kërkuara sipas konkursit.

Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIJA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Br. 256/1  
Datum: 26.02.2024

Na osnovu člana 2 stav 1 Zakona br. 04/L-032 za pred-univerzitetsko obrazovanje u Republici Kosovo, člana 13 Zakona o obrazovanju i stručnom osposobljavanju 04/L-138, stava 1 i 2 Zakona o javnim službenicima br. 08/L-1978, člana 4 stav 2 tačka 2.3 Administrativnog uputstva MONT-a br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora pred-univerzitetske ustanove za javno obrazovanje-vaspitanje i osposobljavanje u Republici Kosovo, Procedurama o izboru i imenovanju, raskidu ugovora i privremenom imenovanju, Administrativnog uputstva 05/2012, Administrativnog uputstva 14/2014, Agencija Za Profesionalno Obrazovanje i Osposobljavanje i Obrazovanje za Odrasle, objavljuje ovaj:

## KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNIH MESTA

### Agencija za Profesionalno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje za odrasle

#### 1. Naziv radnog mesta: Direktor Centra kompetencije

##### 1. Centar kompetencije u Uroševcu;

**Vrsta radnog mesta: na određeno vreme, sa punim radnim vremenom**

**Broj pozicija: Jedna ( 1) pozicija**

**Funkcionalna kategorija: Nivo upravljanja**

**Vrsta pozicije: Službenik u javnoj službi**

**Trajanje imenovanja: Četiri (4) godine**

#### Svrha radnog mesta:

Rukovođenje, upravljanje i nadzor obrazovno-vaspitne ustanove

#### GLAVNE POSLOVNE DUŽNOSTI:

- Upravljanje i opšta administracija ustanove;
- Izrada godišnjeg plana rada i plana razvoja obrazovne ustanove i godišnjih izveštaja o radu;
- Efikasno i efektivno korišćenje sistema za upravljanje informacijama u obrazovanju i poštovanje kodeksa ovog sistema, procedura osiguranja i rokova za ažuriranje potrebnih podataka tokom školske godine;
- Poslovi izbora nastavnika, vrednovanje, disciplina u obrazovnoj ustanovi i druga pitanja vezana za nastavnike i druge radnike u obrazovanju;
- Podrška i nadzor nad implementacijom nastavnog plana i programa;
- Podrška i nadzor nad radom aktiva i stručnih saradnika obrazovno-vaspitne ustanove, kao i drugih mehanizama obrazovne ustanove koji imaju ulogu u vrednovanju rada i kvalitetnom upravljanju radom ustanove;
- Sarađuje sa upravnim odborom obrazovno-vaspitne ustanove (UOOU), odborom roditelja, Nastavničkim odborom, odborom učenika i zajednicom obrazovno-vaspitne ustanove;
- Izveštava najmanje dva puta godišnje pred UOOU;
- Obezbeđuje bezbedno i podsticajno okruženje za decu/učenike, uključujući dodeljivanje i primenu disciplinskih mera prema učenicima, u skladu sa zakonima na snazi;
- Čuvanje dokumenata i podataka, koje obezbeđuje opština ili Ministarstvo obrazovanja i nauke (MONTI);
- Druga pitanja koja su regulisana zakonom o pred-univerzitetskom obrazovanju, podzakonskim aktima usvojenim od strane MONTI-a;

Dužnosti i odgovornosti direktora i zamenika direktora zasnivaju se na zakonima o obrazovanju na snazi, dopunjeni su drugim podzakonskim aktima koji regulišu posebne aspekte preduniverzitetskog obrazovanja na Kosovu.

#### Uslovi:

- Da budu državljani Republike Kosovo;
- Da imaju završeno univerzitetsko obrazovanje na nivou: Master iz oblasti rukovodstva, administracije ili upravljanje u obrazovanju (kvalifikacija od 300 ECTS, najmanje 5 godina univerzitetskog obrazovanja);
- Master obrazovanje (kvalifikacija od 300 ECTS/5 godina univerzitetskog obrazovanja); - Četvorogodišnji nivo (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog obrazovanja) - Četvorogodišnji nivo Bachelor (kvalifikacija 240 ECTS/4 godine univerzitetskog obrazovanja);
- Da imaju stručnu pripremu relevantnih profila;
- Da imaju redovnu nastavničku licencu prema uputstvu za licenciranje nastavnika;
- Da su uspešno završili akreditovani program profesionalne kvalifikacije za rukovodstvo, administraciju ili upravljanje u obrazovanju, na osnovu

standarda profesionalne prakse za direktore škola na Kosovu, odobrenih od MONT-a prema preporukama SSVO;

- Da imaju najmanje 5 godina radnog iskustva u obrazovnom procesu;

#### Neophodni dokumenti:

- Završene fakultetske diplome za odgovarajući nivo kvalifikacije;
- Sertifikati o uspešno završenom programu obuke za rukovođenje, administraciju ili upravljanje u obrazovanju (u nedostatku sertifikata o obuci za rukovođenje u obrazovanju, kandidat prilaže dokaz Master Diplome o rukovođenju);
- Lična dokumenta (izvod iz matične knjige rođenih i lična karta ili pasoš);
- Dokaz da ima nastavničku licencu ili da je u postupku licenciranja;
- Zdravstveno uverenje izdato u poslednjih šest meseci od licencirane zdravstvene ustanove, kojim se dokazuje njegovo zdravstveno stanje;
- Dokaz da kandidat nije pod istragom i dokaz da nije osuđivan za zločin, nasilje ili nepristojna dela koji uključuju decu;
- Dokaz o radnom iskustvu u obrazovno-vaspitnom procesu;
- Izjava pod zakletvom koja dokazuje da u poslednje tri godine kandidat nije bio ni na jednom rukovodećem mestu u strukturama političkih partija.
- Profesionalni portfolio sa dokazima prema uputstvima u prilogu/obrascu H ovog AU;

#### Informacije o pristupu razvojnom planu relevantne UOO

Znajući da je koncept razvojnog plana dotične obrazovno-vaspitne institucije jedna od tačaka pripreme profesionalnog portfolija, vi možete dobiti razvojni plan institucije u Centru kompetencije u Uroševcu.

#### Veze

Kako bismo osigurali maksimalnu transparentnost i jednakost za sve kandidate, podstičemo sve kandidate da pažljivo pročitaju sve priloge navedene u nastavku. Ovi prilozi su sastavni dio procesa selekcije od strane imenovane Komisije.

**Prilog 1 – Administrativno uputstvo (MONT) br.151/2020** o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora javne pred-univerzitetske ustanove za obrazovanje i osposobljavanje, procedurama izbora i imenovanja, raskidu ugovora i privremenom imenovanju.

Veza:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administra-tiv-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dheperjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dheaftesues-parauniversitar-ne-republiken-e/>

**Prilog 2 - Prilozi UA 151/2020** - obuhvataju obrasce koji su ključni za pripremu kandidata, i to:

- Obrazac B - Dokumenti potrebni u skladu sa članom 5. ovog UA
- Obrazac B/1 - Tabela za vrednovanje kandidata za direktora/zamenika direktora UOO na osnovu dokaza prezentiranih na konkursu
- Obrazac C – Protokol intervjua
- Obrazac H - Uputstvo za izradu profesionalnog portfolija
- Obrazac I – Model izjave pod zakletvom

Veza:

<https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-perdrejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-ia/>

**Prilog 3 - Administrativno uputstvo (MONT) 05/2015** - Normativ za nastavnike stručnog obrazovanja

Veza:

<https://masht.rks-gov.net/ua-masht-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhensit-e-arsimitprofesional/>

#### Rok i način prijave

Konkurs ostaje otvoren 30 kalendarskih dana od dana objavljivanja od dt. 26.02.2024 do dt. 26.03.2024.

Podnošenje dokumenata vrši se u Agenciji za stručno obrazovanje i obrazovanje za odrasle (APOOO). Adresa: Ulica "Agim Ramadani" 10000, Priština, treći sprat sa početkom od 09.00-15.00. Prijava se prima i dostavlja upravi APOOO.

Naziv radnog mesta mora biti jasno naveden u prijavi, a dokumenti priloženi uz prijavu moraju biti kopije i ne vraćaju se, osim diploma ovjerenih kod notara.

Kandidati koji su diplomirali van Kosova moraju imati diplome nostrifikovane od strane MONTI;

Uz prijavu je potrebno priložiti: kopiju lične karte, kopije kvalifikacione dokumentacije, radnog iskustva, kao i drugu neophodnu dokumentaciju traženu po uslovima konkursa.

Kao tačne i istinite informacije smatraju se samo one koje su dokazane relevantnom dokumentacijom (ne samo navedene u prijavi);

Prijave dostavljene nakon roka se ne prihvataju, dok se nepotpune prijave odbijaju.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIMIN PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRIUR**  
**AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I**  
**OBRAZOVANJE ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Nr. 257/1  
Datë: 26.02.2024

Bazuar në nenin 2 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenin 13 të Ligjit për Arsimin dhe Aftësimin Profesional 04/L-138, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit për Zyrat Publik Nr. 08/L-197, nenin 4 paragrafi 2 pika 2.3 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it nr. 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institutit Publik Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para universitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, Udhëzimit Administrativ 05/2012, Udhëzimit Administrativ 14/2014, Agjencia e AAAPARr-së, shpallë këtë:

**KONKURS**  
**PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS**

**I. Titulli i vendit të punës: Zëvendësdrejtor në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj**

**1. Qendra e Kompetencës në Ferizaj;**

**Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë**

**Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,**  
**Kategoria Funktionale: Nivel drejtues**  
**Lloj pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik**  
**Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet**

**Qëllimi i vendit të punës:**

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

**DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :**

- Zv. Drejtori , është përgjegjës për marrëdhënie me biznese dhe sigurimin e të hyrave.
- Zv. Drejtori i shkollës, është përgjegjës dhe garanton zhvillimin e aktiviteteve për gjenerimin të të ardhurave;
- Organizimin e kurseve të hapura për punonjësit të ndërmarrjeve të komunitetit lokal;
- Organizim e trajnimeve për zhvillimin dhe aftësimin e të papunëve për tregun e punës në bashkëpunim me zyrën e punësimit;
- Organizimin e panairëve për prezantimin e produkteve të kompanive private dhe publike;
- Dhënie me qira të zyrave me të gjitha pajisjet për bizneset private,;
- Ofrim të shërbimeve këshilluese për ish nxënësit e ndërmarrjeve lokale;
- Bashkëpunon ngushtë me kompanitë private dhe publike;
- Siguron mundësinë e aftësimit dhe punësimit të të gjithë nxënësve në organizata të ndryshme private dhe publike brenda dhe jashtë vendit;
- Motivimin për nxënien për të rritur-personeli dhe prindërit;
- Siguron trajnime dhe aftësime që përshtaten nevojave të tregut të punës;
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. drejtori i shkollës, menaxhon kohën për t'i arritur objektivat organizative;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të identifikoj problemet e mundshme dhe mundësit;
- Zv. drejtori i shkollës, siguron që hapësirat e shkollës, pajisjet dhe sistemi mbështetës të funksionoj në mënyrë efektive dhe efikase;
- Zv. drejtori i shkollës, në bashkëpunim me drejtorin e shkollës , përdor në mënyrë efektive dhe efikase burimet e disponueshme financiare dhe asetet për të përmirësuar rezultatet e të nxënit;

**Kushtet:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar).
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master nga fushat Ekonomisë, kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësive sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësive;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

**Dokumentet e kërkuara:**

- Diplomata e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësive ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

**II. Titulli i vendit të punës: Zëvendësdrejtor në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj**

**Qendra e Kompetencës në Ferizaj**

**Lloji i vendit të punës: me afat të caktuar, me orar të plotë**

**Numri i Pozitave: Një (1) pozitë,**  
**Kategoria Funktionale: Nivel drejtues**  
**Lloj pozitës: Nëpunës i Shërbimit Publik**  
**Kohëzgjatja e emërimit: Katër (4) vjet**

**Qëllimi i vendit të punës:**

Udhëheqja, menaxhimi dhe mbikëqyrja e institucionit edukativo-arsimor

**DETYRAT KRYESORE TË PUNËS :**

- Zv. Drejtori është përgjegjës për zhvillimin e arsimit dhe marrëdhënie ndërkombëtare;
- Zv. Drejtori i shkollës, kujdeset dhe është përgjegjës për zhvillimin e arsimit dhe bashkëpunimin me donatorët dhe institucione rajonale dhe të BE-së,
- Kujdeset për zhvillimin dhe aftësimin pedagogjik dhe profesional të mësimdhënësve,
- Motivon stafin e mësimdhënësve që të involvohen në bashkëpunim ndërkombëtarë,
- Kujdeset dhe është përgjegjës për krijimin e grupeve për hartimin e projekteve për institucione ndërkombëtarë,
- Është përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve në hartimin e projekteve me AAAPARr-në,
- Kujdeset për arritjen në shtetet e BE-së në sferën e AAP-së dhe në përshtatjen e tyre për nevojat e shkollës,
- Bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë për përgatitjen e nxënësve për tregun e jashtëm,
- Bashkëpunon ngushtë me drejtorin dhe zëvendës drejtorin për biznes;
- Zv. drejtori i shkollës, bën matjen dhe vlerësimin: Vlerësimin për të nxënët dhe Vlerësimin e të nxënët;
- Zv. drejtori i shkollës, është i obliguar që të mbaj komunikim të vazhdueshëm me palët e ndryshe të interesit;
- Zv. drejtori i shkollës, avokon për mbështetjen e komuniteti për shkollë dhe sistem më të gjerë të arsimit;
- Zv. drejtori i shkollës, inkurajon dhe modelon nxënien gjatë gjithë jetës për nxënësit dhe personelin;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të shfrytëzoj burime të ndryshme të informatave për vendimet të cilat ndikojnë në mirëqenien e nxënësve në shkollë ;
- Zv. drejtori i shkollës, duhet të njeh mundësit e teknologjisë së re dhe asaj në zhvillim, dhe bën të mundur integrimin e tyre të plot në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënies;

Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit/eshës dhe zëvendësdrejtorit/eshës mbështeten në ligjet për arsim në fuqi, ato plotësohen edhe me akte të tjera nënligjore që rregullojnë aspekte të veçanta në arsimin parauniversitar në Kosovë.

**Kushtet:**

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- Të kenë të kryer arsimin universitar të nivelit: Master për udhëheqje administrim ose menaxhim në arsim (kualifikim prej 300 ECTS, se paku 5 vite të shkollimit universitar);
- Master arsimorë (kualifikimin prej 300 ECTS/5 vite të shkollimit universitar); - Katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar) – Bachelor katërvjeçar (kualifikimin prej 240 ECTS/4 vite të shkollimit universitar);
- Të kenë licencë të rregullt të mësimdhënësive sipas udhëzimit për licencim të mësimdhënësive;
- Të ketë përgatitje profesionale të profileve përkatëse;
- Të kenë përfunduar me sukses një program të akredituar të kualifikimit profesional për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim, të bazuar në standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, të aprovuar nga MASHTI sipas rekomandimeve të KSHLM;
- Të ketë së paku 3 vite përvojë pune në procesin edukativo- arsimor;

**Dokumentet e kërkuara:**

- Diplomata e fakultetit të kryer për nivelin përkatës të kualifikimit;
- Certifikatat për kryerjen me sukses të programit të trajnimit për udhëheqje, administrim ose menaxhim në arsim (në mungesë të certifikatës së trajnimit për udhëheqje në arsim kandidati/ja ofron dëshminë e diplomës Master për udhëheqje);
- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe letërnjoftimi ose pasaporta);
- Dëshmi se ka licencë të mësimdhënësive ose që është në procedurë të licencimit;
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar në gjashtë muajt e fundit nga një institucion i licencuar shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore ;
- Dëshminë se kandidati nuk është nën hetime dhe dëshminë se nuk ka qenë i/e dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët;
- Dëshmi të përvojës së punës në procesin edukativo- arsimor;
- Deklaratën në betim që vërteton se në tri vitet e fundit kandidati/ja nuk ka qenë në asnjë funksion udhëheqës në strukturat e partive politike.
- Portfolio profesionale me dëshmi sipas udhëzimeve në shtojcën/formularin H të këtij UA;

**Informimi për qasje në planin zhvillimor të IEAA-së përkatës**

Duke ditur se koncepti i Planit Zhvillimor të institucionit edukativ-arsimor përkatës është një prej pikave të përgatitjes së portofolios profesionale, Planin Zhvillimor të institucionit mund ta merrni në Qendrën e Kompetencës në Ferizaj.

**Veçezat elektronike:**

Për të siguruar transparencë dhe barazi maksimale për të gjithë kandidatët, i inkurajojmë të gjithë kandidatët që t'i lexojnë me kujdes të gjitha Shtojcat e listuara më poshtë. Këto shtojca janë pjesë përbërëse e procesit përzgjedhës nga Komisioni i emëruar.

**Shtojca 1 -Udhëzimi administrativ (MASH) NR.151/2020** për Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe të zëvendësdrejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/udhezim-administrativ-mash-nr-151-2020-per-de-tyra-t-dheperjegjesite-e-drejtorit-dhe-te-zevendesdrejtorit-te-institucionit-publik-edukativo-arsimor-dheaftesues-parauniversitar-ne-republikene-e/>

**Shtojca 2- Shtojcat e UA 151/2020** - perfshiren Forumaret te cilat jane kyç per përgatitjen e kandidatëve, përkatësisht:

- Formulari B - Dokumentet e kërkuara sipas nenit 5 të këtij UA
- Formulari B/1 - Tabela e vlerësimit për kandidatin për drejtor/zëvendësdrejtor të IEAAP në bazë të dëshmi të prezantuar me rastin e konkurimit
- Formulari C - Protokoll i Intervistimit
- Formulari H - Udhëzime për përgatitjen e portfolios profesionale
- Formulari I - Model i Deklaratës nën Betim

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/shtojca-e-ua-151-1-formularet-per-vlersimin-e-kandidatve-perdrejtor-dhe-zevendesdrejtor-te-ia/>

**Shtojca 3 -Udhëzimi administrativ (MASH) 05/2015-** Normativi për Mësimdhëniesit e Arsimit Profesional

Linku:

<https://masht.rks-gov.net/ua-mash-nr-05-2015-normativi-per-mesimdhenesit-e-arsimitprofesional/>

**Afati dhe mënyra e aplikimit**

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike nga data e publikimit nga dt. 26.02.2024 deri me dt. 26.03.2024

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAAPARr). Adresa: Rruga "Agim Ramadani" 10000, Prishtinë, kati i tretë duke filluar nga ora 09.00-15.00. Aplikacioni merret dhe dorëzohet në administratën e AAAPARr-së.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen, përveç diplomave të noterizuara.

Kandidatët që kanë diplomuar jashtë Kosovës, duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga MASHTI;

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e kualifikimit, përvojës së punës, si dhe dokumentet tjera të nevojshme të kërkuara sipas konkursit.

Si informata të sakta dhe të vërteta, konsiderohen vetëm informatat që janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo vetëm të deklaruara në aplikacion);

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Qeveria –Vlada-Government*  
**AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR**  
**AGENCIJA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE**  
**ZA ODRASLE**  
**AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION**

Br. 257/1  
Datum: 26.02.2024

Na osnovu člana 2 stav 1 Zakona br. 04/L-032 za pred univerzitetsko obrazovanje u Republici Kosovo, člana 13 Zakona o obrazovanju i stručnom osposobljavanju 04/L-138, stava 1 i 2 Zakona o javnim službenicima br. 08/L-1978, člana 4 stav 2 tačka 2.3 Administrativnog uputstva MONT-a br. 151/2020 o dužnostima i odgovornostima direktora i zamenika direktora pred-univerzitetske ustanove za javno obrazovanje-vaspitanje i osposobljavanje u Republici Kosovo, Procedurama o izboru i imenovanju, raskidu ugovora i privremenom imenovanju, Administrativnog uputstva 05/2012, Administrativnog uputstva 14/2014, Agencija Za Profesionalno Obrazovanje i Osposobljavanje i Obrazovanje za Odrasle, objavljuje ovaj:

### KONKURS ZA POPUNJAVANJE RADNIH MESTA

Agencija za Profesionalno obrazovanje i osposobljavanje i obrazovanje za odrasle

I. Naziv radnog mesta: Zamenik direktora Centra kompetencije u Uroševcu

1. Centar kompetencije u Uroševcu;  
Vrsta radnog mesta: na određeno vreme, sa punim radnim vremenom  
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija  
Funkcionalna kategorija: Nivo upravljanja  
Vrsta pozicije: Službenik u javnoj službi  
Trajanje imenovanja: Četiri (4) godine

Svrha radnog mesta:

